

FJALA E DEPUTETES MIRELA PITUSHI

E ENJTE 4 NËNTOR 2021

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Dua ta përqendroj fjalën time pikërisht në këtë hap të rëndësishëm, në miratimin e disa ndryshimeve të nënshkuara në marrëveshjen “Për prodhimin dhe furnizimin me vaksinën Pfizer”, të miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021 të Këshillit të Ministrave. Sot është tepër me vlerë që ne deputetët, përmes votës sonë, t’i hapim rrugë çdo iniciative qeveritare, në dobi të sigurimit dhe të përdorimit të vaksinave anti-Covid, si një masë eficiente për të pasur një klimë të shëndetshme të popullsisë, qoftë në zonat rurale, qoftë në ato urbane. Masat jetike nuk kanë munguar dhe vazhdojnë të forcohen për të gjitha grupmoshat, duke filluar tashmë edhe në moshat e reja.

E mira dhe e keqja kanë qenë kurdoherë në duel me njëra-tjetrës. Ashtu si edhe sot, ne ndeshemi me mendime pozitive dhe mbështetëse për kryerjen e procesit të vaksinimit, por edhe me përpjekjet për të frenuar këtë proces, duke u ngritur me hamendësime, kur, realisht, faktet kanë treguar përfitimet nga dozimi i vaksinave. Duke parë rëndësinë e këtij akti normativ, jam e bindur se nga vënia në zbatim e tij do të kemi më shumë sasi vaksinash në dobi të popullatës, e cila do të jetë më e mbrojtur para këtij kërcënimi të padukshëm, por real dhe me rreziqe të shumta për të gjitha grupmoshat. Për mendimin tim, duhet t’i japim fund një herë e mirë përplasjes dhe mendimeve se ishim të vonuar në fillim të vaksinimit masiv, apo të vazhdojmë të përplasemi me fjalë me njëritjetrin, në vend që të njohim një mobilizim pa dallim partiak, për të pasur një popullatë sa më të mbrojtur dhe të shëndetshme.

Të nderuar kolegë, edhe pse situata është më pak alarmante se në fazat e mëparshme të pandemisë, të gjithë jemi të vetëdijshëm që problematika është tepër aktuale dhe shqetësuese, pasi çdo ditë kemi të infektuar, në kurba të ulëta apo të larta, por edhe humbje të jetëve të njerëzve të infektuar nga virusi. Të gjithë jemi dëshmitarë të lajmeve vërtet tronditëse të humbjeve të jetëve të njerëzve që na rrethojnë. Të gjithë jemi në një shfaqje pendese, kur pohojmë se i ndari nga jeta kishte nguruar të bënte vaksinën, ashtu si shumë të tjerë pohojnë se nëse do të kishte bërë vaksinën, edhe mund të kishte shpëtuar. Faktet kanë treguar se janë të rralla rastet e humbjes së jetës kur është bërë vakcina, dhe më tepër në njerëz me probleme të rënda shëndetësore.

Në stadin ku ndodhemi, me masat e shumta që qeveria shqiptare vazhdon të marrë çdo ditë në drejtim të sigurimit të sasisë së nevojshme për vaksinim dhe për kalimin e saj në dozën e tretë për një kategori të caktuar, nga kjo foltore, ju bëj thirrje bashkëqytetarëve të mi fierakë, qytetarëve të mbarë Shqipërisë, të mos hezitojnë për të kryer procesin e vaksinimit. Duhet të rritet shkalla e ndërgjegjësimit të popullatës, sepse, përveç përfitimit, nuk ju vjen asgjë e keqe nga vakcina. Të gjithë e njohim tashmë sloganin: “Vakcina të mbron. Virusit të vret”. Faleminderit!